


YENDIMËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC NE EMËR TË POPULLIT



30. 03. 2018
 GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni

Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Hakile Ilazi, me zytaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të akuzuarës [REDACTED], për shkak të veprës penale Rrezikim trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1036-5/2016 të datës 27.10.2017, në praninë e prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, si dhe të akuzuarit, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik më dt. 29.01.2018, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 28.02.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

E akuzuara: [REDACTED], e lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] në me vendbanim në Shtime rr. [REDACTED], e martuar, nënë e shtatë fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, e pa punësuar, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës me numër personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 12.06.2016, rreth orës 11:40, në rrugën "Anton Çeta", përballë barnatore "Aspirin" në Shtime, e pandehura duke drejtuar automjetin e markës "Hundai", me ngjyrë portokalli, me targë të regjistrimit [REDACTED] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 42 par. 1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve, fillon kyçjen në komunikacion pa u bindur mirë se nuk i rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, dhe gjatë kthimit tërthorazi për ta kaluar rrugën për të hyrë në parkingun e Qendrës Emergjente me pjesën e djathtë të përparme e godet në derën e pasme të majtë automjetin e markës "Citroën Picasso", me targa të regjistrimit [REDACTED], me ngjyrë hiri, të cilin e drejtonte [REDACTED] i cili nga goditja e humb kontrollin mbi automjetin duke kaluar në anën e majtë dhe me pjesën e parë të anës së djathtë e godet në pjesën e përparme të anës së djathtë automjetin e markës "Renault", me targa të regjistrimit [REDACTED] me ngjyrë të bardhë, të cilin e drejtonte [REDACTED] që në atë moment ishte

ndaluar, ku pos dëmeve materiale, lëndime trupore pësojnë [REDACTED] dhe [REDACTED] të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 29.09.2017.

me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 7, 8, 9, 17, 23, 41, 73, 74, 85 dhe 86 të KPRK-së, si dhe , nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin i shqipton,

VËREJTJE GJYQËSORE

- E pandehura u njoftua se vepra e tillë përbën veprë penale, veprë e dëmshme dhe e rrezikshme, si dhe nëse e njëjta prapë kryen veprë të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.
- Të dëmtuarit: [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Shtime si dhe [REDACTED] nga Shtimja rr. [REDACTED] nr. [REDACTED], për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 25 Euro /njëzet e pesë/ si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumë prej 60.88 Euro /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent), në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar e pandehura gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1036-5/2016 të datës 27.10.2017 ka ngarkuar të akuzuarën [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 29.01.2018 në të cilën shqyrtim fillestar: e akuzuara e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është e vetëdijshme për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë aksident, është hera e parë që ndeshet me ligjin, premtion gjykatës që në të ardhmen do të shtoj kujdesin në komunikacion, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit Sebahate Sinani duke shprehur mendimin e saj përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarës, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarën ta shpall fajtor dhe të i shqipton vërejtje gjyqësore.

Pasi që e akuzuara ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 KPPK-së, edhe pas udhëzimit në kuptim të nenit 323 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe atë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjekoligjor i datës 29.08.2017, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit i datës 12.09.2017.
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se e akuzuara ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual komfor nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka

vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit,

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të akuzuarën [REDAKTUAR], të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe atë veprimet e kundërligjshme të kryera nga i akuzuari me çka rezultoi nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjkata të pandehurit si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë duke shprehur keqardhje dhe pendimin e thellë, nënë e shtatë fëmijëve përkatësisht mbajtëse e familjes, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, pendimin e saj, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarën dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi bazë të këtyre rrethanave i shqiptoj vërejtje gjyqësore si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPK-së dhe nenin 85 dhe 86 të KPRK-së, gjykata i shqiptoi të akuzuarës vërejtjen gjyqësore, duke u bërë atyre me dije se kanë kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale për të cilën nëse ajo sërish kryen vepër të tillë, gjykata do të shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Gjkata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se e akuzuara në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 41 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzet e pesë euro/ si dhe shpenzimet e procedurës penale për ekspertizë mjeko-ligjore dhe ekspertizën e komunikacionit shumën 60.88 Euro /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent) në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.2728/17, me dt. 28.02.2018

**Zyrtare ligjore,
Ganimete Avdiu**

Gjyqtari:

Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.